Nr. 4160 Prot
dt. 05.11.2026

- Senatit Akademik
- Bordit Administrativ
- Administratorit
- Dekanave
- Zv. Rektorës

9.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 8224/2 Prot. Tiranë, më 30. 10. 2026

Lënda: Dërgohet urdhër për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR
Adresa: Sheshi "2 Prilli", nr. 24, Shkodër

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 527, datë 30.10.2026 të Ministrit të Arsimit "Për procesin zgjedhor për autoritetin drejtues "Rektor" në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër"".

Duke Ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Jona Suli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 8224/1 Prot.

Tiranë, më 30.10.2026

U R DH Ë R

Nr. 527, datë 30/10.2026

PËR
PROCESIN ZGJEDHOR PËR AUTORITETIN DREJTUES "REKTOR" NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 129 dhe 131 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U R DH Ë R O J:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetin drejtues "Rektor" në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, në datën 13.11.2026.

2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetin drejtues "Rektor" në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, në datën 14.12.2026.

3. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër të marrë masat që të miratojë rregulloren e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit zgjedhor.

4. Kandidatët për autoritete drejtuese në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, me qëllim garantimin e integritetit të lartë, përpara aplikimit duhet të kenë marrë vlerësim pozitiv nga Këshilli i Etikës, i cili verifikon ligjshmërinë e fitimit të gradës shkencore dhe titullit akademik, përfshirë kontrollin antiplagjiaturë. Kriteri i vlerësimit të kandidatëve nga Këshilli i Etikës dhe procedurat, të përcaktohen në rregulloren përkatëse të zgjedhjeve të IAL-së.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

M I N I S T R E

MIRELA KUMBARO FURXHI